



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 05.02.2025

Nr: 65

Ora: 12:00

VENDIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË  
DENONCIMIN NR. 3, DATË 03.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,  
TË ORGANIZATËS QENDRA “QENDRESA QYTETARE”**

Sot më datë 05.02.2025, Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Organizata Qendra “Qendresa Qytetare”

**OBJEKT:**

1. Konstatimin e përdorimit të burimeve publike.
2. Marrjen e sanksioneve administrative bazuar në dispozitat ligjore ndaj të gjithë personave të kallëzuar, si dhe atyre që do të identifikohen gjatë hetimit administrativ.
3. Ndalimin e angazhimit online, pavarësisht formës së shprehur nëpërmjet komentimit, pëlqimit apo shpërndarjes, të institucioneve publike me publikimet e titullarit të institucionit publik, si dhe fshirjen e menjëhershme të të gjitha postimeve me karakter elektoral nga faqet e institucioneve publike.

**BAZA LIGJORE:** Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullaror

**K O N S T A T O J :**

Organizata Qendra “Qendresa Qytetare”, ka paraqitur denoncimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, më datë 03.02.2025, nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail.

Denoncimi është regjistruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 3, në datën 03.02.2025.

Data: 05.02.2025

Nr: 65  
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 3, datë 03.02.2025 të regjistrit të denoncimeve, të Organizatës Qendra “Qendresa Qytetare”

Nga shqyrtimi paraprak i të dhënave që përmban denoncimi si dhe dokumentat bashkëlidhur tij pretendohet si vijon:

*“Në faqet zyrtare të institucioneve të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë drejtoritë e shërbimit spitalor, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, spitalet bashkiake dhe qendrat shëndetësore, janë angazhuar me shpërndarjen e postimeve që janë tërësisht me përmbajtje politike”.*

Nga sa më sipër çmuj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:

- Drejtorit të Shërbimit Spitalor Tepelenë;
- Drejtorit të Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Kolonjë;
- Drejtorit të Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës;
- Drejtorit të Spitalit Bashkiak Tropojë;
- Drejtorit të Spitalit Bashkiak Delvinë;
- Drejtorit të Spitalit Bashkiak Pukë;
- Drejtorit të Spitalit Bashkiak Kolonjë;
- Drejtorit të Qendrës Shëndetësore Paskuqan;
- Drejtorit të Qendrës Shëndetësore Bregu Lumit;
- Partisë Socialiste të Shqipërisë.

2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**